



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 256, datë 16.07.2020**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94 e 95 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**V E N D O S I :**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Rexhep Karaj dhe Murat Lleshi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal për të pandehurin {...}; “Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psikike”, parashikuar nga neni 88/a i Kodit Penal për të pandehurin {...}; “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal për të pandehurin {...}.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat; Objekti: “Bashkim dënimesh për të dënuarin {...}”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; Objekti: “Dërgimin e çështjes në gjyq dhe kërkesë për pushim procedimi”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Plagosjes së rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/2 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë dhe “Mbajtjes së armës lufturake në ambientet publike pa lejen e organit kompetent”, parashikuar nga nenet 76-22 dhe 278/4 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kreshnik Omari dhe Ahmet Metaliaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria Kurbin; i pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 78/1 e 22, 278/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Arben Micko dhe Sokol Pasho, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria Kurbin; i pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 101/2 e 106 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Enkeleda Kapedani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Neni 143/1 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Tomorr Kullolli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Neni 291 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Enkeleda Kapedani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Neni 278/1 i Kodit Penal”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Taulant Tafa, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Neni 283/1 i Kodit Penal”.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Enkeleda Kapedani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Objekti: “Verifikim mase mjekësore”.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Tomorr Kullolli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Neni 283/a/2 i Kodit Penal”.

7. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Taulant Tafa, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Llogaritje dënimi të shlyer”.

8. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Shpëtime Pitaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; e paditur: {...}; Objekti: “Shfuqizim vendimi”.

9. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Dhurata Bilo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen civile me palë paditëse: Shoqëria “{...}”; e paditur: {...}; Objekti: “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET**

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Suela Xhani dhe Enkeleda Doda, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjyqësor Përmet; i pandehur: {...}; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Shkëlzen Liçaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; Akuza: “Vrasje me paramendim”, “Mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të gjuetisë e sportive”, parashikuar nga nenet 78/1, 278/1 dhe 280 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Pëllumb Vehbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; i kallëzuar: {...}; Objekti: “Kundërshtim i vendimit për mosfillim të procedimit penal sipas kallëzimit nr.1363, datë 29.10.2019. Prishje e vendimit duke urdhëruar Prokurorinë Sarandë duke kryer hetimet e nevojshme”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për gjykim procedimi penal {...} viti 2018 për veprën penale “Kultivim bimësh narotike”; “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 284/2 dhe 278/1/3 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Florin Demollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: “Nenet 248, 186/2 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Merita Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; i pandehur: {...}; Akuza: “Neni 199/a, paragrafi 3 i Kodit Penal”.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Olkeda Manellari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, çështjen penale me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; e pandehur: {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje narkotikësh”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Arben Lera dhe Ariola Kristo, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; i pandehur: {...}; Akuza: “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi 2 i Kodit Penal”.

## **GJYKATA E APELIT DURRËS**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj (relatore), Astrit Kalaja dhe Valbona Vata, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Mbajtja pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/6 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me kërkuese: {...}; Objekti: “Shuarje dënimi”.

## **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: Shoqëria Përmbartimore “{...}”, {...}, etj.; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbartimore”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: Shoqëria {...}; të paditur: Shoqëria {...}, {...}, etj.; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; e paditur: {...}; Objekti: “Pavlefshmëri titulli ekzekutimi”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, Elona Toro dhe Elbana Lluri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; e paditur: Zyra Përmbartimore “{...}” sh.p.k; person i tretë: {...}; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbartimore”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Olsi Xhavelli (relator), Mimoza Margjeka si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me kërkuese: {...}; Akuza: “Pushim procedimi penal”.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Mimoza Margjeka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; Akuza: “Kundërshtim vendimi për mosfillimin e çështjes penale”.

7. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Mimoza Margjeka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim.

8. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Hysen Saliko, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”.

9. Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Dhimitër Lara, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitje e narkotikëve”. “Moskallëzimi i Krimit”.

10. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} dhe {...}; Objekti: “Kërkesë për pushimin e çështjes penale”.

11. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Klodiana Gjyzari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Pezullim ekzekutimi vendimi, etj.”

12. Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Dhimitër Lara, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; Objekti: “Kundërshtim vendimi”.

13. Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Dhimitër Lara, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Vrasja në lidhje me një krim tjetër”.

14. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Olsi Xhavella, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; Objekti: “Kundërshtim vendimi mosfillimi”.

## **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Shkëlqim Mustafa, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: “Vjedhje me dhunë”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Shkëlqim Mustafa, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: “Rebelimi i të burgosurve”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuror {...}; Objekti: “Dërgim për gjykim të çështjes penale që i përket procedimit penal {...}, datë

11.01.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, me të pandehur {...}, për akuzën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143-3, i Kodit Penal;  
Pjesëmarrës procedural me cilësinë e pandehur dhe person nën hetim: {...};  
Pjesëmarrës procedural me cilësinë e person nën hetim: {...}.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Shkëlqim Mustafa, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Lirim me kusht”.

6. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi dhe Tritan Hamitaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Falsifikim i dokumenteve”.

7. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Tritan Hamitaj dhe Valbon Çekrezi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Kultivim i bimëve narkotike”; “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”.

8. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, Shoqëria “{...}”; i paditur: Përmbarues gjyqësor {...}; person i tretë: {...}; Objekti “Sigurim padie” (Objekti i shqyrtimit: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”).

## **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të:

1) Kërkesës nr.39 prot., datë 13.07.2020, me të pandehur {...}, me objekt: “Dërgim i çështjes në gjyq, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/3 të Kodit Penal”.

2) Kërkesës nr.40 prot., datë 13.07.2020, me të pandehurit {...}, akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Sokol Binaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, etj.; Akuza: “Neni 143/2 i Kodit Penal”.

## **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; Objekti: “Kundërshtim i vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për mosfillimin e procedimit penal me {...}”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Izet Salaj (relator), Dritan Banushi dhe Enton Dhimitri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit

Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; person i interesuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier; Objekti: “Shfuqizimi i urdhrorit të ekzekutimit {...}, datë 19.01.2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Shuarja e dënimit duke e përjashtuar nga ndjekja penale të vendimit {...}, datë 21.05.2012”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Dritan Banushi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Shpërdorim detyrë” “Falsifikim i dokumentave”.

### **GJYKATA E APELIT TIRANË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj (relator), si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër Lindita Hoxha dhe Aleks Nikolli, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; person i tretë: Zyra e Përmbarrimit {...}, etj.; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbarrimore”.

### **GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Ridvan Hado, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Përjashtimin e trupit gjykues”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Përjashtimi i trupit gjykues të përbërë nga {...}, {...} dhe {...} nga shqyrtimi i ankimit kundër vendimit {...} alti, datë 20.05.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**KRYETARE**

**NAUREDA LLAGAMI**

Organizimi i mbledhjeve: K.Kasaj  
Drejtoria juridike: V. Kaloshi  
Sekretar i Pergjithshem: R. Baqli  
Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: I.Toska